



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:147978

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05508105

PPP.nr.242/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen përmbartimore të kreditorit SH.A. KUR-M J.S.C., me numër fiskal, adresa: K-M, kundër debitorit M.S, me adresë K-M, për shkak të pagesës së borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm- kartela financiare e konsumatorit CODE:....., për pagesën e borxhit në shumën prej 3,040.05 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit për lejimin e propozimit përmbartimor të përmbartuesit privat A.M, me seli në M, P.nr.4093/20 të datës 03.11.2020, jashtë seancës gjyqësore, me datën 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit M.S, nga M, SHFUQIZOHET pjesërisht urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.4093/20 të datës 03.11.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat A.M, me seli në M dhe atë për shumën e borxhit prej 2,680.53 euro, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2018.

II. REFUZOHET pjesërisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e urdhrit të përmbartuesit privat A.M, me seli në M, P.nr.4093/20 të datës 03.11.2020, për shumën e borxhit prej 359.52 euro, për periudhën nga data 31.01.2019 deri me datën 31.09.2020.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, URDHËROHET që paraprakisht të paguaj garancionin në të holla në shumën prej 359.52 euro, si parakusht për ushtrimin e ankesës, e në qoftë se dështon të paguaj atë, ankesa do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare.

A r s y e t i m

Kreditori, SH.A. KUR "M" J.S.C., me seli në M, më datën 03.11.2020, ka parashtruar propozim për përmbarrim, ndaj debitorit M.S, te përmbarruesi privat A.M, me seli në M, duke kërkuar që në emër te borxhit të faturuar nga data 01.01.2013 deri me datën 26.10.2020 sipas ekstraktit të verifikuar nga kartela financiare, debitori t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 3,040.05 euro, si dhe shpenzimet e përmbarrimit dhe kamatën ligjore.

Përmbarruesi privat A.M, me seli në M, me urdhër përmbarrues P.nr.4093/20 të datës 03.11.2020, ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarrimore.

Ndaj urdhrorit të lartcekur në afatin ligjor, ka paraqitur prapësim debitori, ku ndër të tjera ka theksuar se e kundërshton urdhrin përmbarrimor për arsye se borxhi me të cilin jam ngarkuar më është faturuar në mënyrë paushalle e duke më ngarkuar në mënyrë jo të drejtë me borxh. Po ashtu, borxhi i lartcekur është parashkruar konform nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarrimor P.nr.4093/20 të datës 03.11.2020 të anulohet.

Kreditori brenda afatit ligjor, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin si të pa pabazuar dhe të pa arsyeshëm, sepse propozimi për përmbarrim është paraqitur në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstrakteve të verifikuar në librat afarist. Sa i përket pretendimeve të debitorit se i njëjti thirret në parashkrim sipas nenit 360 të LMD-së, ka theksuar se kemi ndërprerje të parashkrimit për arsye se debitori ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nga kompania, e në këtë rast kemi të bëjmë me përtëritje të borxhit (novacion), por debitori ka dashur t'i ikë përgjegjësi dhe ka qenë i pandërgjegjshëm. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të bëhet ekzekutimi i propozim përmbarrimit nga debitori në llogari të kreditorit në shumën e borxhit të mbetur prej 3,040.05 € dhe prapësimi i debitorit të hedhet poshtë si i pa bazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrorit për përmbarrim, prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se:

- prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata, fillimisht vlerësoi propozimin për përmbarrim të paraqitur nga kreditori dhe konstatoj se i njëjti është paraqitur konform dispozitës ligjore të nenit 38 të Ligji për Procedurën Përmbarrimore Nr.04/L-139 (në tekstin e mëtejshëm LPP-së) dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me këtë dispozitë, duke ia bashkëngjitur të njëjtit dokumentin e besueshëm në origjinal,

në bazë të cilit kërkohen përbarimi, përkatësisht ekstraktit e verifikuar nga librat afariste, i cili ekstrakt është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përbarim, në kuptim të dispozitave të nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të LPP-së, ku përcaktohet se “ *përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është:1.1. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa në par.3 të këtij nenin thuhet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Për çka pretendimin e debitorit se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri përbarimor nuk është titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përbarueshmerisë, gjykata e mori si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të debitorit, lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit “*ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përbarimi*”, për shumën prej 2,680.53 euro, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2018, për shkak të parashkrimit të kërkesës duke u bazuar në nenin 360 të Ligjit Mbi Marrdhëniet e detyrimeve nr.04/L-077, i cili është në fuqi që nga data 20.12.2012, në të cilin theksohet se “*1.Kërkesat të cilat parashkruhen për një (1) vit, 1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*”. Po ashtu në të njëjtin nen në par.2 thuhet se “*Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë*” ndërsa në par.3 është paraparë se “*Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë*”. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet e ujësjellësit për nevoja shtëpiake, të cilat kërkesa hynë në kategorinë e kërkesave një vjeçare, gjykata vlerësoi se ka kaluar afati i paraparë me dispozitën e lartcekura – afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, andaj edhe vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendosja në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të pa bazuar, erdhi pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, sepse kreditori e ka ndërprerë parashkrimin duke parashtruar propozim për përbarim me datën 12.11.2019, bazuar në nenin 369 të LMD-së, ku theksohet se “*Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër*

debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës". Pra, urdhri përmbartimor për pjesën e borxhit që përfshin periudhën nga data 31.01.2019 e deri me datën 26.10.2020, në shumë prej 359.52 euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë të kërkesës është ndërprerë parashkrimi dhe nuk ka arritur afati i paraparë me neni 360 të LMD-së.

Gjykata, vlerësoj pretendimin e kreditorit, lidhur me ndërprerjen e parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, për faktin se gjykata askund në shkresat e lëndës nuk gjeti ndonjë deklaratë të debitorit me të cilën e pranon borxhin e kërkuar nga kreditori, e po ashtu nuk gjeti që i njëjti të ketë bërë ndonjë pagesë në emër të këstit, të kamatës apo dhënie të sigurimit ashtu siç e kërkon dispozita e lartcekur. Andaj, gjykata konsideron se pranimi i borxhit nga ana e debitorit duhet të bëhet vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklaratë të debitorit me gojë ose me shkrim, pranimi i borxhit duhet të jetë në atë drejtim që debitori manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet në tërësi apo një pjesë e tij, përveç deklaratës të cilën debitori i'a bën kreditorit, pranimi i borxhit mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë siç është pagesa e këstit, kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit, si dhe mund të bëhet edhe me pagesën e kamatës ose dhënien e mjetit të sigurimit të kërkesës së kreditorit, pra lënia e sendit peng. Këto veprime të debitorit duhet të kenë për qëllim pranimin e borxhit, pra vet debitori është ai që manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet, andaj bazuar në të cekurat më lartë e në kuptim të nenit 368 të LMD-së, gjykata vlerësoi se pagesat e rregullta nuk e ndërprejnë parashkrimin, sepse ka dallim esencial në mes të pagesës së kistit dhe pagesave të rregullta, pagesa e kësteve mund të bëhet vetëm pas një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit për pagesën e një borxhi të caktuar në këste të caktuara, ndërsa pagesat e rregullta bëhen nga ana e debitorit varësisht nga shërbimet e marra nga kreditori, për këtë arsye gjykata vlerësoi se pagesat e rregullta nuk paraqesin vullnet të debitorit për pranimin e borxhit paraprak në tërësi, mirëpo këto pagesa bëjnë shlyerjen e borxhit të parë të krijuar të debitorit në drejtim të kreditorit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pabazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbartimin e lejuar, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, ashtu siç kërkohet me neni 69 par.4 të LPP-së, në të cilin thuhet se “ *Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet*”.

Në bazë të nenit 78 par.1, 2 dhe 4 të KPP-së, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e urdhëruar debitorin që në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, paraprakisht të paguaj garancionin në të holla si parakusht për ushtrimin e ankesës dhe gjykatës t'ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit. Lartësia e garancionit është përcaktuar duke marr për bazë shumën e borxhit për të cilën ka mbetur në fuqi urdhri përmbarues. Si dhe është paralajmëruar debitori që nëse dështon të paguaj garancionin, ankesa do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare.

Andaj, nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.242/2022 me datën 26.03.2024

Gjyqtari,

Leart Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.